



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1621 / prot.
3

Tiranë më 22 11.2018

VENDIM

Nr. 68, datë 22.11.2018

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", neneve 77-112 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Vendimit nr. 49/2017 të Kuvendit "Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj" si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Bashkia Shkodër",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 274 datë 30.10.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Bashkia Shkodër", me objekt:

- Verifikim i zbatimit të Rekomandimit Nr.11 datë 06.06.2016, Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "Bashkia Shkodër".

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "Bashkia Shkodër", konstaton se:

1. Kontrolluesi, nuk ka publikuar një rubrikë të veçantë "politikë e privatësisë", në zbatim të pikës së parë të Rekomandimit Nr. 11/2016 të Komisionerit. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18, pika 1, të Ligjit Nr.9887/2008 "Për

Mbrojtjen e të Dhënave Personale”: “Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit...”.

Informacioni i publikuar në “*Politikat e Privatësisë*”, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

2. Kontrolluesi “*Bashkia Shkodër*”, në zbatim të nenit 21 të ligjit, ka “*Njoftuar*” në vitin 2011 Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Nga verifikimi në vend dhe për shkak të ndryshimeve në kohë të mjeteve dhe mënyrave të përpunimit të të dhënave, të kategorive të të dhënave, qëllimeve të përpunimit etj., konkludohet se ky “*Njoftim*” duhet përditësuar. Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1 të nenit 21 dhe nenit 22 të Ligjit Nr. 9887/2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”: “...*Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë*”.

Përditësimi i njoftimit është një nga detyrimet më të rëndësishme ligjore i cili në vështrim të nenit 21 të ligjit, duhet të kryhet kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji.

3. Kontrolluesi, nuk ka hartuar rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në zbatim të pikës së tretë të Rekomandimit Nr.11/2016 të Komisionerit. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit Nr.9887/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, pika 2/1: “*Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera.*”.

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi i një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe përdorimi i saj nga nëpunësit e tij, si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe detyron punonjësit për ruajtjen e konfidencialitetit, ruajtjen nga keqpërdorimi dhe mënyrën e administrimit të të dhënave personale.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin e datës 31.10.2018, të cilin përfaqësuesi i kontrolluesit nuk e ka nënshkruar dhe për arsye procesverbali është dorëzuar në protokollin e Institucionit me nr. 18179/2 datë 31.10.2018.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, kontrolluesi “*Bashkia Shkodër*” është njoftuar të marrë pjesë në datën 13.11.2018 ora 11:00, në seancë dëgjimore që do të zhvillohej pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit. Në datën 13.11.2018 ora 10:10, kontrolluesi ka njoftuar

nëpërmjet postës elektronike info@bashkiashkoder.gov.al kërkesën për shtyrjen e seancës dëgjimore, në pamundësi për tu paraqitur në orën dhe datën e caktuar nga Zyra e Komisionerit. Në përgjigje të kërkesës së kontrolluesit, Zyra e Komisionerit e ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike, për shtyrjen e seancës dëgjimore në datën 20.11.2018 ora 11:45. Kontrolluesi është paraqitur në seancë, por nuk ka dokumentuar rikuperimin e shkeljeve apo marrjen e masave konkrete për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ të cilat konsistojnë në mos informimin e subjekteve mbi përpunimin e të dhënave personale në portalin www.bashkiashkoder.gov.al, mos përditësimin e "Njoftimit" pranë Zyrës së Komisionerit mbi përpunimin e të dhënave personale si dhe mungesën e rregullores specifike "Për mbrojtjen, përpunimin, dhe ruajtjen e të dhënave personale", në kuptim të nenit 39, pika 1, gërmat "b", "d" dhe "dh" të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë:

- b) "Kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10.000 deri në 300.000 lekë";
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) "Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10.000 deri në 150.000 lekë".

Në bazë të nenit 39/2 të Ligjit Nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysht faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 21, 27, 29, 30, 39 pika 1 gërmat "b", "d" dhe "dh", si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale",

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Bashkia Shkodër", me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
2. Dënimin e kontrolluesit "Bashkia Shkodër", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

3. Dënimin e kontrolluesit "Bashkia Shkodër", me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
4. Kontrolluesi "Bashkia Shkodër", në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të informojë subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale, qëllimin e përpunimit, mjetet dhe mënyrat e përpunimit, përhapjen e të dhënave etj., nëpërmjet "Politikës së Privatësisë" në portalin zyrtar <http://www.bashkiashkoder.gov.al>.
5. Kontrolluesi "Bashkia Shkodër", në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të kryejë pranë Zyrës së Komisionerit përditësimin e "Njoftimit" në lidhje me kategoritë e subjekteve të të dhënave, kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, qëllimet e përpunimit etj.
6. Kontrolluesi "Bashkia Shkodër", në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të hartojë rregulloren për "Mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave" në përputhje me veprimtarinë dhe strukturën organizative.
7. Kontrolluesi "Bashkia Shkodër", të ketë në vëmendje respektimin e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe Udhëzimin nr. 39/2013 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale në regjistrat publikë" gjatë administrimit dhe publikimit të të dhënave personale që përmbajnë Vendimet e Këshillit Bashkiak, listat e personave që përfitojnë ndihmë ekonomike, listat e nxënësve që marrin bursë, listat e pagesave për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimet e tjera që iu ofrohen qytetarëve.
8. Kontrolluesi "Bashkia Shkodër", të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga pikat 4, 5 dhe 6 të këtij vendimi, brenda një afati 30 ditor, duke vënë në dijeni Zyrën e Komisionerit për përmbushjen e tyre.
9. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit.
10. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 22.11.2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

